



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KRYETARI
URDHËR

Nr. 654 Datë 7 / 11 / 2016

**PËR NGRITJEN E NJËSISË PËRGJEGJËSE PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN
E SINJALIZUESVE**

Bazuar në nenin 64 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 816 datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve””, **Kryetari**

URDHËRON :

1. Ngritjen e Njësisë Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
2. Njësia Përgjegjëse në strukturën e saj do të përbëhet nga **Znj. Athinulla Trebicka** me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe **Znj. Elida Hajdini** me detyrë Inspektor i Lartë i Auditit të Brendshëm në Bashkinë Korçë.
3. Punonjësi i Njësisë Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve e kryen këtë detyrë krahas detyrave dhe funksioneve të pozicionit të punës.
4. Caktimi si punonjës i Njësisë Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve është pa afat dhe përfundon me mbarimin e marrëdhënieve të punës si nëpunës i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Korçë.
5. Znj. Athinulla Trebicka dhe Znj. Elida Hajdini të përgjigjen për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji nr 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”
6. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
7. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Sotiraq FILO

